

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka-kryetare e kolegjit, Nesrin Lushta e Marije Ademi-anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Arben Ismajli-proçesmbajtës, në çështjen penale të të akuzuarit B. Xh. nga fshati K. komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297. par.5. lidhur me par. 3. dhe 1. të KPK, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësve të të akuzuarit dhe ankesave të të dëmtuarve H. Rr. e I. H., të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr.485/2009 të datës 26.11.2010., në seancën e mbajtur konform nenit 410. të KPPK, më datën 08.03.2012., mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e mbrojtësve të të akuzuarit B. Xh. dhe ato të dëmtuarve H. Rr. e I. H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr. 485/2009 i datës 26.11.2010, vërtetohet.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P.nr. 485/2009, të datës 26.11.2010, i akuzuari B. Xh. është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297. par.5., lidhur me par. 3. dhe 1. të KPK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues

ndalimi i drejtimit të automjetit për afat kohor prej 3 (tri) vitesh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I akuzuari është obliguar të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor, shumë prej 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Për realizimin e kërkesës pronësoreshë juridike, të dëmtuarit janë udhëzuar në kontestin civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar:

- mbrojtësit e të akuzuarit, avokatët M. S. e O. H. nga Prishtina, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo të ndryshohet, ashtu që i akuzuari të lirohet nga aktakuza, apo t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë, mundësisht i kushtëzuar,

- i dëmtuari I. H., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi maksimal i paraparë për këtë vepër penale dhe

- i dëmtuari H. Rr., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të ligjit material, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi maksimal i paraparë për këtë vepër penale.

Edhe pse në ankesat e të dëmtuarve theksohen bazat e sipër përmendura ankimore, nga përmbajtja e ankesave del se aktgjykimin e atakojnë për shkak të vendimit për dënimin, me propozimet e cekura më lartë.

Prokurori i shtetit, me parashtresën PPA.nr.134/2011 të datës 06.04.2011, ka propozuar që ankesa e mbrojtësve të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të aprovohen ankesat e të dëmtuarve dhe të merret aktgjykim sikurse është propozuar në këto ankesa.

Palët dhe mbrojtësit e të akuzuarit, me rregull ishin të informuar për seancën e kolegjit të Gjykatës Supreme. Prokurori i Shtetit dhe i akuzuari nuk prezantuan, ashtu që konform dispozitës së nenit 410. par. 4. të KPPK, seanca u mbajt pa praninë e tyre, ndërsa mbrojtësit e të akuzuarit pasi dhanë disa sqarime, ngelën pranë pretendimeve dhe propozimeve ankimore.

Kolegji i gjykatës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës bashkë me ankesat e paraqitura dhe propozimin me shkrim të Prokurorit të Shtetit dhe pasi që aktgjykimin e ankimuar studioi sipas detyrës zyrtare konform nenit 415. par.1. të KPPK, gjeti se:

- ankesat nuk janë të bazuara.

Duke e goditur aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, mbrojtësit e të akuzuarit në ankesë, pretendojnë se i njëjti është i përfshirë me shkelje nga neni 403. par. 1. pika 12. të KPPK, sepse në dispozitiv e as në arsyetim, përshkrimi faktik i veprës penale nuk është paraqitur në mënyrë të drejtë dhe të plotë, nuk janë prezantuar faktet dhe rrethanat me rëndësi lidhur me shkaktimin e aksidentit. Më konkretisht, në ankesë thuhet se në dispozitivin e aktgjykimit, nuk është përcaktuar me saktësi veprimi i tejkalimit të veturës - nuk dihet cilën veturë e ka tejkaluar i akuzuari, sa ka qenë e lejuar shpejtësia e vozitjes në vendin e ndodhjes së aksidentit dhe për sa i akuzuari e ka tejkaluar shpejtësinë e lejuar, edhe pse këto fakte ceken në arsyet e aktgjykimit, siç nuk është

konstatuar se në pjesën e ndarjes fizike në mes dy shiritave/kahjeve, nuk ka qenë e vendosur pjesa mbrojtëse dhe a është dashur që automjeti Volkswagen të qarkullojë në shiritin e majtë të rrugës, kur dihet se ka qenë e dedikuar për transportin e personave të hendikepuar. Ankuesit më tutje pretendojnë se dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë edhe sa i përket vet rrjedhjes së ngjarjes kritike dhe faktorëve që kanë ndikuar në ardhjen e aksidentit, sepse arsyet nga të cilat del se i vetmi shkaktar i aksidentit ka qenë i akuzuari nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me provat e administruara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkele esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat në ankesë pretendohen, sepse dispozitivi i tij është i qartë, në përputhje me arsyet e dhëna dhe aktgjykimi përmban arsye ligjore për të gjitha faktet vendimtare.

Nuk qëndron pretendimi se, nga dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë nuk mund të kuptohet se cilin automjet i akuzuari e ka tejkalar. Përkundrazi, në dispozitiv shkruan se i akuzuari me automjetin e vet, me të cilin ka vozitur në shiritin e djathtë (rruga në të dy kahjet i ka nga dy shirita), ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit të veturës, e cila qarkullonte para tij në shiritin e majtë, veturë kjo e markës Volkswagen LR TDI AG4 kombi. Pastaj, në dispozitiv theksohet se ngjarja ka ndodhur në rrugën magjistrale dhe se i akuzuari ka zhvilluar shpejtësi me të madhe se sa ka qenë e lejuar, ndërsa në arsyetim precizohet se në rrugën magjistrale, kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes është 80 km/h, ndërsa i akuzuari ka zhvilluar shpejtësinë prej 100,4 km/h. Andaj, nuk ka paqartësi apo kundërthënie në mes dispozitivit me arsyet e aktgjykimit, siç pa bazë pretendohet në ankesën e mbrojtësve të të akuzuarit, por përkundrazi, për faktet e qarta të cekura në dispozitiv, janë dhënë arsye më të detajzuara dhe ligjore.

Mos ekzistimi i pjesës mbrojtëse në mes dy rrugëve, sipas aktgjykimit të shkallës së parë, nuk ka kontribuar shkaktimit të aksidentit, siç nuk ka qenë relevante se kombi i “Hendikosit” a ka pasur të drejtë të vozisë në shiritin e majtë (pra më të shpejtë) të rrugës, andaj, këto nuk ceken në dispozitivin e aktgjykimit, ndërsa me të drejtë arsyetohen, sepse kanë qenë pjesë e vlerësimit të provave të nxjerra, si dhe të pretendimeve të mbrojtësve të të akuzuarit, e për të cilat do të bëhet fjalë më poshtë.

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat shqyrtohen detyrimisht.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar vendin dhe kohën e ndodhjes së aksidentit, pjesëmarrësit dhe pasojat e shkaktuara. Këto nuk vihen në dyshim dhe nuk kontestohen as në ankesa. Sipas gjetjes së gjykatës së shkallës së parë, shkas i ndodhjes së aksidentit kanë qenë tejkalimi i veturës kombi nga i akuzuari, veprim ky të cilin e ka ndërmarrë pa u vërtetuar paraprakisht se mund ta bëjë, pa e rrezikuar komunikacionin, shpejtësia më e madhe se sa ajo e lejuar në këtë vend, që për pasojë kanë pasur prekjen e pjesës së përparme të djathë të kombit, humbjen e kontrollit mbi veturë dhe barturën - kalimin në rrugë në drejtim të kundërt ku ka ardhur, deri te goditja me automjetet e markës “Daimler Benz 124” dhe “Ford Mondeo”, të cilat kanë qarkulluar nga drejtimi i kundërt.

Gjendja faktike, sipas ankesës së mbrojtësve të akuzuarit nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, sepse janë anashkaluar dy faktorë të rëndësishëm që i kanë kontribuar ardhjes së aksidentit dhe është marrë se vetëm një faktor - faktori njeri, në rastin konkret i akuzuari, kinse me lëshimet e tij ekskluzive, ka shkaktuar aksidentin e

komunikacionit. Faktorët tjerë, sipas ankesës janë, rruga, gjegjësisht mungesa e mbrojtësit në mes dy shiritave/kahjeve të rrugës dhe faktori automjet, gjegjësisht rregullsia teknike e automjetit të të akuzuarit. Me rëndësi të veçantë ka qenë konstatimi dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit dhënë me shkrim dhe gojarisht në shqyrtimin gjyqësor, i cili pretendohet se ka qenë jo profesional, nuk ka dhënë përgjigje në pyetjet për faktorët elementarë, gjegjësisht, kjo ekspertizë është e mangët, ndërsa gjykata i ka kushtuar besimin dhe këtë provë si dhe provat tjera të administruar, i ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme, që ka rezultuar me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nuk ka pasur indikacione se automjeti i të akuzuarit nuk ka qenë në gjendje të rregull, sepse ai asnjëherë nuk ka pohuar një fakt të këtillë, e në anën tjetër eksperti i komunikacionit ka gjetur se bartja e automjetit mund të shkaktohet për shkak të mosfunksionimit të sistemit të frenimit, por në rastin konkret, deri te bartja e automjetit nuk ka ardhur për atë shkas, por automjeti i të akuzuarit është bartur pasi e ka goditur/prekur automjetin, të cilin ka tentuar ta tejkalojë. Gjykata e shkallës së parë, drejtë ka konkluduar se gjetja e ekspertit është e drejtë, sepse siç më poshtë do të shpjegohet, kjo provë ka qenë në përputhje me provat tjera të administruara.

Sipas ankesës, faktori tjetër-“faktori rrugë” ka ndikuar në shkaktimin e aksidentit dhe gjendja faktike edhe për këtë fakt është vërtetuar në mënyrë të gabuar. Kështu, sipas ankesës, shkaktar i aksidentit është edhe mungesa e mbrojtësit në mes dy drejtimeve. Mirëpo, ky fakt nga mbrojtja është potencuar edhe gjatë procedurës së shkallës së parë dhe nga eksperti i komunikacionit është kërkuar përgjigje dhe eksperti qartazi ka deklaruar se ekzistimi i mbrojtjes do të kishte ndikuar që të mos vinte deri te aksidenti në përmasa të këtilla, por jo edhe se ky është faktor i shkaktimin të vet aksidentit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, janë të pabazuara thëniet ankimore se eksperti ka dhënë konstatim dhe mendim jo profesional, i cili nuk ka mbështetje në provat e administruara. Përkundrazi, në kohën e dhënies së ekspertizës, eksperti, siç edhe vetë ka deklaruar, ka pasur në dispozicion të gjitha shkresat e lëndës dhe konstatimi dhe mendimi i tij janë në përputhje, pra nuk kanë asnjë paqartësi apo kundërthënie me provat tjera të administruara, siç janë skica dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, në të cilat shihen gjurmët në rrugë, dëmtimet dhe pozita e fundit e automjeteve, si dhe deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar. Andaj, Gjykata Supreme vlerësoi se kjo ekspertizë dhe provat tjera të administruara janë vlerësuar konform dispozitës së nenit 387. par. 2. të KPPK, në bazë të cilave të gjitha faktet vendimtare janë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ndërsa pretendimi ankimor nuk ishte i bazuar dhe si i tillë nuk u aprovua.

Nga gjendja faktike, e cila është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, drejtë është aplikuar ligji penal, për çka nuk kishte bazë as pretendimi ankimor se deri te aksidenti nuk ka ardhur me fajin e të akuzuarit dhe se nuk ka pasur bazë që ai të shpallet fajtor për veprën penale në fjalë. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje tjera të ligjit penal, të cilat shqyrtohen detyrimisht.

Me rastin e shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar në pjesën e cila ka të bëjë me vendimin për sanksionin penal, Gjykata Supreme konstatoi se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat nga neni 64. të KPPK dhe me këtë rast, si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka marrë rrethanat se më parë nuk është i gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, është njeri familjar, babë i dy fëmijëve, sjelljet e tij korrekte dhe faktin se në këtë aksident edhe vetë ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndërsa si rënduese shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe se i akuzuari

është njeri i arsimuar dhe me funksion të lartë politik, si kryetar i Kuvendit Komunal në F.

Mbrojtësit e të akuzuarit, në ankesë potencojnë se rrethanat lehtësuese nuk janë çmuar në mënyrë adekuate, që ka rezultuar me dënim të lartë të shqiptuar, se nuk ka mundur që si rrethanë rënduese të konsiderohet pozita e lartë momentale politike e të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është më i lartë se sa është politika e ndëshkimit për këto vepra penale, andaj se duhet të shqiptohet dënim dukshëm më i butë, mundësisht i kushtëzuar.

Të dëmtuarit H. Rr. dhe I. H., pretendojnë se i akuzuari ka vepruar me një pakujdesi të rëndë, duke shkaktuar pasoja shumë të rënda. Në ngjarjen kritike ka humbur jetën L. Rr., ndërsa i dëmtuari I. H. ka pësuar lëndime aq të rënda trupore, sa që tri javë ka qenë pa vetëdije, ka pasur shumë intervenime kirurgjike dhe pasojat ende nuk janë sanuar, ndërsa edhe disa persona tjerë kanë pësuar lëndime të rënda trupore dhe është shkaktuar dëm i madh material. Sjelljet e të akuzuarit edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë qenë jo korrekte, sepse si pasojë e mos përgjigjes së tij ftesave të gjykatës, shumë seanca janë shtyrë. Ai nuk ka kontaktuar familjet e të dëmtuarve më parë, por në kohën kur seancat gjyqësore kanë filluar. Kanë propozuar që aktgjykimi të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënimi maksimal i paraparë për këtë vepër penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, faktet relevante që ndikojnë në marrjen e vendimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ka vend për shqiptimin e dënimit më të butë, apo më të lartë. Rrethanat që tregojnë se ankesa e mbrojtësve të të akuzuarit është e pabazuar, janë se shkalla e rrezikshmërisë shoqërore e kësaj vepre penale është e lartë, për shkak të pasojave të rënda të shkaktuara, me vdekjen e një personi, lëndimet e



rënda të shkaktuara tre personave, prej të cilëve dy kanë qenë të rrezikshme për jetë në momentin e shkakimit, lëndime të lehta trupore të shkaktuar një personi dhe dëm material në tri automjete. Deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve ekskluzive të të akuzuarit. Megjithatë, nuk mund të aprovohen as pretendimet në ankesat e të dëmtuarve, sepse i akuzuari edhe vetë ka pësuar lëndime të rënda trupore, fakt ky i cili ka mundur t'a pengojë që më shpejtë të kontaktojë me familjet e tyre, ndërsa rrethanat tjera janë marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk kanë karakter të atillë që të ndikojnë në rritjen e dënimit.

Andaj, duke gjetur se të gjitha rrethanat relevante jo vetëm se janë konstatuar, por drejtë janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Supreme gjeti se ankesat nuk janë të bazuara, sepse dënimi i shqiptuar është i ligjshëm, në harmoni me rrethanat e rastit, i nevojshëm dhe i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të paraparë me dispozitën e nenit 34. të KPPK, për ç`arsye ankesat u refuzuan si të pabazuara.

Nga sa u tha, në bazë të nenit 423. të KPPK, u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
Ap.nr. 134/2011, më 08.03.2012.

PROCESMBAJTËSI  
KOLEGJIT  
Arben Ismajli

KRYETARJA E  
Valdete Daka

ANËTARËT TË KOLEGJIT:

Nesrin Lushta\_\_\_\_\_

Marije Ademi\_\_\_\_\_